



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

SCL-11-0024

*Ankuesja*

D A B Serbi.

*Kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit,**  
Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 25 maj 2022, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. Ankesa e ankueses D A, refuzohet si e pabazuar.**
- II. Vërtetohet Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, nr. PEJ127-0025/0026/0112/0113, i datës 05 gusht 2011, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 06 qershor 2007, ankuesi ka dorëzuar një Kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), në të cilën ka kërkuar kompensimin për paga të papaguara në shumë prej 17,160.00 €, për periudhën kohore nga viti 1999-2007, nga N.SH "Pashtriku" (në likuidim).

Me 05 gusht 2011, Autoriteti i Likuidimit me Vendimin nr.PEJ127-0025/0026/0112/0113, e ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga ankuesja, si të pavlefshme.

Me 29 tetor 2011, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr.PEJ127-0025/0026/0112/0113 dhe ka kërkuara nga Gjykata që ta aprovoj ankesën e saj për kompensimin për paga të pa paguara, në shumë prej 17,160.00 €, nga N.SH "Pashtriku" (në likuidim). Ka theksuar se marrëdhënia e punës në NSH, nuk i është ndërprerë, por për arsye të sigurisë nuk ka mundur të paraqitet në punë që nga viti 1999.

Ankuesja ka bashkangjitur në kopje: vendimin e kundërshtuara të AL, aktgjykimin Dhomës së Posaçme SCEL-06-0017, formularin e kërkesës të paraqitur tek AL, librezën e punës, letërnjoftimin, vërtetimin nr.239, dt.11 qershor 1999.

Me 14 shkurt 2017, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se ankesa është e pabazuar dhe kërkoi që vendimi i atakuar i AL të vërtetohet. AKP më tej pohon se kërkesa për paga është e parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar i cili parasheh afatin 3 vjeçar për pagimin e pagave të papaguara. Sa i përket barrës së provave e paditura i është referuara nenit 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe nenit 23 të Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme qe ishte në fuqi. Ka shtuar se parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që të vërtetoj se ka ofruara shërbime pune për N.Sh-në për periudhën 1999-2007, prandaj edhe kompensimi për pagat e kërkuara nuk ka bazë ligjore. I ka propozuar gjykatës refuzimin e ankesës si të pabazuar dhe vërtetimin e vendimit të atakuar të AL.

Me 20 shkurt 2017, gjykata ka dërguara mbrojtjen e të paditurës për përgjigje tek ankuesja, mirëpo ankuesja nuk ka paraqitur përgjigje.

Për detaje të tjera referoheni tek shkresat e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, nr. PEJ127-0025/0026/0112/0113, i datës 05 gusht 2011, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), Gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në lidhje me meritat e lëndës, Gjykata vëren se ankuesja i ishte adresuar AL-së për zbatim të kërkesës së tij për pagat e papaguara, në shumë prej 17,160.00 €, për periudhën kohore nga viti 1999-2007, nga N.SH “Pashtriku” (në likuidim), por kërkesa ishte refuzuar nga AL përmes Vendimit nr. PEJ127-0025/0026/0112/0113, të datës 05 gusht 2011 PRN051-0190, me arsyetimin se kërkesa ishte parashkruar në bazë të neni 608 i ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) dhe mungesës së provave.

Gjykata e konsideron të drejtë përfundimin e AL-së se padia është parashkruar. Sa i përket parashkrimin të kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara, Gjykata është e mendimit se neni 608 i ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili hyri në fuqi më 01 nëntor 2010, e i cili në dispozitat e tij qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha Ligjeve ekzistuese të Punës në Kosovë. Megjithatë, Ligji i Punës nr. 03/L-212 nuk parasheh parashkrim

në lidhje me pagesat e të ardhurave. Prandaj, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978 i cili ishte në fuqi deri me hyrjen në fuqi më 19 dhjetor 2012 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, ishte tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së).

Veç tjerash, rregullat e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 LMD, neni 387 dhe 388 rregullon ndërprerjen e afatit të parashkrimit dhe shprehimisht definon se afati i parashkrimit mund të ndërpritet vetëm kur debitori e pohon borxhin ose nëse kreditori ndërmerr një veprim për të filluar procedurat ligjore në një gjykatë apo organ kompetente me qëllim të konfirmimit, garantimit apo realizimit të kërkesës së tillë.

Gjykata gjen se kërkesa e ankueses është e pabazuar, meqë ankuesja nuk ka dorëzuar asnjë provë para AL dhe gjykatës se ajo ka kërkuar më parë pagat e papaguara para se të parashtronte kërkesë në AL në vitin 2007.

Ankuesja ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit të pretenduar në kohën kur nuk i janë paguar pagat, përkatësisht në kohën kur N.Sh-ja i ka mbetur borxh, kështu që afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë menjëherë pasi ka lindur e drejta e kërkesës. Ankuesja ka kërkuar kompensimin e pagave nga vitit 1999-2007. Gjykata gjen se Kërkesa e ankueses për pagat e pa paguara, për periudhën 1999 deri në maj 2004 është parashkruar referuar dispozitave të lartcekura, ndërsa pagat e papaguara prej qershorit të vitit 2004 deri në qershor 2007, nuk janë parashkruar, meqë ankuesja ka paraqitur kërkesën e saj për paga tek AL me 06 qershor 2007, e cila edhe e ka ndërpre afatin e parashkrimit. Gjykata konstaton se edhe pse kërkesa për kompensimin e pagave për periudhën prej qershorit 2004 deri në qershor 2007 nuk është parashkruar, konsiderohet si e pa bazuara, meqë ankuesja me asnjë provë nuk ka provuara se ka ofruar shërbime pune në N.SH "Pashtriku", apo se N.SH i ka mbetur borxh ankueses.

E paditura përveç që është thirrur në parashkrim të kërkesës e ka kundërshtuar kompensimin dhe mungesën e provave, ndërsa ankuesja nuk ka ofruara ndonjë dëshmi relevante që ta dëshmojë të kundërtën. Ankuesja po ashtu me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor relevantë që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket të drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore kompensimin për pagat e papaguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të kundërshtuar. Provat e bashkangjitura nga ankuesja nuk kanë pasur ndikim për të vendosur ndryshe nga ajo që është arsyetuara.

Edhe Ligji i Procedurës Kontestimore në nenin 7, por edhe Ligji NR.06/L-086 për Dhomën e Posaçme në nenin 31.5, parasheh detyrimin e palës dhe barrën e provës.

Gjykata po ashtu gjen si të pabazuar edhe pretendimin e ankueses të ngritur me ankesë se asaj i takon kompensimi për paga, meqë ajo ka qenë përfituese e 20%, sipas Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme SCEL-06-0017. Çështja e 20 % është një çështje krejt tjetër dhe një procedure e veçantë e cila ka të bëjë me pjesën e të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore e që është e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13, prandaj nuk ndërlidhet asgjë me

rastin në fjalë. Këtë qëndrim gjykata, madje e ka shprehur edhe në shumë aktgjykime të lëshuara me parë.

Nga arsyet e lartë cekura dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 8.1.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesja është i liruar nga pagimi i taksës gjyqësore.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar